



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 127 prot.

Pukë, më 21. 01. 2025

URDHËR

Nr. 22, datë 21/01/2025

**“PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT TË
KONFLIKTIT TË INTERESIT NË BASHKINË PUKË”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar; të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të akteve nënligjore dhe procedurave të brendshme për administrimin e konfliktit të interesit në institucion,

URDHËROJ:

1. Të krijohet dhe administrohet në Bashkinë Pukë “Regjistri për Identifikimin, Deklarimin dhe Trajtimin e Rasteve të Konfliktit të Interesit”, si dokument zyrtar administrativ për evidentimin, trajtimin dhe monitorimin e rasteve të konfliktit të interesit në institucion.

2. Regjistri të përmbajë të dhëna lidhur me:

- ✓ evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit;
- ✓ deklaratimet e punonjësve;
- ✓ masat e marra për shmangien ose eliminimin e konfliktit;
- ✓ vendimmarrjet administrative përkatëse;
- ✓ datën e mbylljes së trajtimit të rastit.

3. Ngarkohet struktura përgjegjëse për burimet njerëzore / koordinatori për etikën dhe integritetin institucional për:

- ✓ administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit;
- ✓ evidentimin e rasteve të deklaruara;
- ✓ ruajtjen e dokumentacionit shoqërues;
- ✓ raportimin periodik pranë Titullarit të institucionit.

4. Çdo punonjës i Bashkisë Pukë ka detyrimin:

- të deklarojë menjëherë çdo situatë konflikti interesi aktual, të mundshëm ose në dukje;
- të vetëpërgjashtohet nga procedurat administrative apo vendimmarrëse ku ekziston konflikt interesi;
- të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse për administrimin e rasteve.

5. Mosdeklarimi i konfliktit të interesit, fshehja e të dhënave apo mosrespektimi i këtij urdhri përbën shkelje administrative dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ngarkohen të gjithë drejtuesit e njësive organizative për zbatimin dhe monitorimin e këtij urdhri.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

DENISA MEÇI

